

VENDIM
Nr. 30, datë 26.3.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA
NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, neni 14 pika 1 germa “a”, si dhe të rregullave dhe procedurave “Për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror” neni 4, pika 1 germa “a”; neni 8, neni 9 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2 germa “a” dhe nenin 10, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albpetrol sh.a.”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol sh.a.”, për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albpetrol sh.a.” në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani